



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 92, Datë 28.05.2024

MONITORIM I KYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	SHTËPIA E TË MOSHUARVE SHKODËR
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP X • Reklamim nga të tretë
Numri i kontratave	4 (katër) Kontrata
Konstatimet kryesore	1. Plani i zbatimit të kontratave ka mangësi përsa i përket çështjeve organizative e teknike të kontratës, që lidhen me monitorimin e zbatimit të saj. 2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me pikën 1, të nenit 124, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe pikës 7, të nenit 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi për kontratat objekt hetimi, nuk ka administruar gjatë zbatimit të kontratës gjithë dokumentacionin e nevojshëm, si dhe nuk ka kryer verifikimet përkatëse, për të siguruar që malli i dorëzuar i plotëson kërkesat e cilësisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. Gjithashtu, referuar të dhënave të dokumenteve shoqëruese të mallit, rezulton një artikull nuk përmbushin specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.
Masat e marra	Në bazë të neneve 23, gërma “e”, dhe 132, pika 1, gërma “k, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, APP vendosi të dënojë me gjobë 5 persona të evidentuar përgjegjës për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në vendim.